



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

PROJEKTVENDIM

Nr. \_\_\_\_/2024

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR  
TRAJTIMIN E TË DHËNAVE TË SISTEMIT TIMS

Në mbështetje të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VE NDOSI :

- Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Trajtimin e të Dhënave të sistemit TIMS.
- Komisioni Hetimor ka për objekt të veprimtarisë së tij:
  - Shqyrtimin e çështjeve lidhur me kontrollin e veprimtarisë së institucioneve të ngarkuara me mbrojtjen e sistemit TIMS; dhe
  - Vlerësimin e nevojës për marrjen e masave administrative apo, ndërhyrjet ligjore në legjislacionin përkatës në fuqi.
- Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për cdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes së pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve të drejtësisë, parimin për një proces të rregullt ligjor, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e paanshmërisë dhe i respektimit të jetës private të individit.
- Komisioni Hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime për marrjen e masave administrative dhe/ose ndryshime ligjore.
- Komisioni Hetimor do të përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë, nga të cilët kryetari dhe 6 (gjashtë) anëtarë propozohen nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe 8 (tetë) anëtarë propozohen nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste si me poshte:

1. Z. Ervin Salianji  
2. Z. Toni Gogu

Kryetar  
Nënkryetar

PD  
PS

3. Z. Nasip Naço	Anëtar	PS
4. Znj. Blerina Gjylameti	Anëtar	PS
5. Znj. Etilda Gjonaj	Anëtar	PS
6. Z. Xhemal Qefalia	Anëtar	PS
7. Znj. Antoneta Dhima	Anëtar	PS
8. Z. Bardhyl Kollçaku	Anëtar	PS
9. Z. Denis Deliu	Anëtar	PS
10. Znj. Lindita Metaliaj	Anëtar	PD
11. Z. Lefter Gështenja	Anëtar	PD
12. Z. Asllan Dogjani	Anëtar	PD
13. Z. Ramadan Likaj	Anëtar	PD
14. Z. Luan Baçi	Anëtar	PD
15. Z. Elda Hoti	Anëtar	PD

*Anëtarët Zëvendësues*

1. Z. Eduart Nreca	Anëtar zëvendësues	PS
2. Z. Laer Duraj	Anëtar zëvendësues	PS
3. Z. Bledion Nallbati	Anëtar zëvendësues	PD
4. Z. Isuf Celaj	Anëtar zëvendësues	PD

6. Komisioni Hetimor do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 4 - mujor, nga data e miratimit të këtij vendimi. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar të Komisionit, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së komisionit.
7. Ngarkohen Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni Hetimor.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R J A**

**Lindita NIKOLLA**

Miratuar në datën \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2024